



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:117220

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06225217

C.nr.3355/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen kontestimore të paditësit S.S. nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit, me vlerë të kontestit 624.00 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 30.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.S. nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore 27.09.2021 – 21.11.2022, për 209 ditë pune, duke llogaritur nga 2 euro në ditë, t’ia paguaj paditësit shumën prej 418.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 18.04.2024, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, e kërkuar më tepër se shuma e aprovuar si në pikën I të këtij dispozitivi, sa i përket periudhës kohore 22.01.2021 – 27.09.2021, në shumën prej 206.00 euro.

III. DETYROHET e paditura që t’ia paguaj shpenzimet e procedurës paditësit në shumën e përgjithshme prej 99.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 18.04.2024 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, në vlerë prej 624.00 euro.

Në padi ka theksuar se paditësi është i punësuar te e paditura në Gjimnazin “Xhavit Ahmeti” në Gjilan, në cilësinë e mësimit dhe vazhdon të jetë në të njëjtën pozitë me orar të plotë të punës. Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (në vijim: KKAK) të datës 22.01.2021 ka shtuar se paditësit i takon kompensimi për shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore

22.01.2021 – 21.11.2022. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën t’ia kompensojë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në shumën prej 624.00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro për përpilim të padisë dhe 20.00 euro për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 10.07.2024 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese që kanë të bëjnë me paditësit e sektorit të arsimit, të mbështetura në Kontratat Kolektive të Arsimit të vitit 2017 dhe 2021 dhe Vendimin e Qeverisë të vitit 2008, sa i përket kërkesave për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, udhëtimit, inflacionit, diferencës në pagë në bazë të kualifikimit, e pagës jubilarë. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shkak të shpenzimeve të ushqimit, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Sa i përket kompensimit për orë shtesë mbi normën e punës, kjo kërkesë nuk gjen mbështetje ligjore, si dhe kontrata kolektive në fjalë zbatohet vetëm deri më datë 21.11.2022, andaj çdo kërkesë pas kësaj date duhet të refuzohet. Sa i përket kompensimit për punë gjatë vikendit (pandemi), bazuar në vendimin e MASHT-it, nr.01b/292 të datës 28.09.2021 paditësit kanë qenë të obliguar që ditët e humbura punuese gjatë kohëzgjatjes së pandemisë t’i zëvendësojnë, e në rastin konkret kemi të bëjmë me orë të zëvendësuar, e jo orë shtesë. Ka konsideruar se paditësit nuk kanë shtjerrë paraprakisht mjetet e brendshme të ankimit, bazuar në nenin 78, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilën refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi është i punësuar te e paditura dhe për periudhën kohore 01.03.2020 – 21.11.2022 ka gjithsej 372 ditë të pranisë në punë, ndërsa për periudhën kohore 27.09.2021 – 21.11.2022 ka gjithsej 209 ditë të pranisë në punë (vërtetimi nr.prot.268/23 i dt.07.12.2023 i lëshuar nga Gjimnazi “Xhavit Ahmeti” në Gjilan).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I dhe jo themelësia e kërkesëpadisë e refuzuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, paragrafi 5 se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”; lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, nga neni 3, paragrafi 2 që përcakton se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; neni 35, paragrafi 7 se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2€ (dy euro) për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit të kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.209/2023 të datës 05.10.2023.

Nga të theksuarat më lartë, gjykata vendosi t’ia aprovojë pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditësit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi gjeti se të njëjtës i takon kompensimi i shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore 27.09.2021 – 21.11.2022, ndërsa lartësinë e vërtetoi duke ia llogaritur nga 2 euro në ditë, si në nenin 35.7 të KKAK-së.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi ka gjetur se kërkesa e paditësit është pjesërisht e përfshirë në parashkrim të kërkesës.

Në nenin 87 të LP-së, është përcaktuar se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, prandaj gjykata duke marrë parasysh faktin se kërkesa e paditësit është kërkesë monetare nga marrëdhënia e punës dhe e paditura është thirrë në parashkrim të kërkesës, gjeti se për 3 vite mbrapa nga data e inicimit të padisë në këtë gjykatë (18.04.2024), pjesa tjetër e kërkesës së paditësit deri më datë 18.04.2021 është e parashkruar.

Gjykata ka parasysh faktin se i ka refuzuar paditësit edhe një pjesë të kërkesës që nuk është e përfshirë në parashkrim, nga data 18.04.2021 e deri më datë 27.09.2021, mirëpo në mungesë të

provave për të vërtetuar se sa ditë ka vijuar në shkollë paditësi për këtë periudhë, gjykata vlerësoi se nuk mund t'ia kompensojë shpenzimin e ushqimit paditësit, i cili kompensim realizohet vetëm për aq ditë sa i punësuari ka qenë në punë.

Për më tepër, gjykata vlerëson se është detyrim i paditësve të mbështesin me prova faktet e tyre bazuar në nenin 7 të LPK-së, prandaj në mungesë të provave për këto periudhë, gjykata i refuzoi të pabazuar të njëjtat dhe i njohi vetëm periudhën për të cilën vërtetohet sa ditë të pranisë ka qenë paditësi në punë, e këto ditë, nuk përfshihen në parashkrim të kërkesës.

Sa i përket pretendimit të të paditurës se paditësi nuk i ka shtjerrë mjetet e brendshme të ankimit, gjykata vlerëson se në kategorinë e të drejtave nga marrëdhënia e punës sa i përket kompensimit monetar, mund të adresohet kërkesa drejtpërdrejtë në gjykatë, pa u ndjekur fare procedura e brendshme administrative.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime (përpilimin e padisë dhe taksën gjyqësore), ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, ashtu që për përpilim të padisë në kontestet e vlerës së vogël (nën 500.00 euro), llogaritet shuma prej 78.00 euro.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.3355/24, datë 30.09.2024

Gjyqtarja,
Edona Zuzaki

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.